

albinfo.ch

Published on *albinfo.ch* (<http://www.albinfo.ch>)

[Home](#) > Të rinjtë me familje kosovare në fokus të studiuesve shkencorë

Të rinjtë me familje kosovare në fokus të studiuesve shkencorë

By *gervalla*

Created 29/03/2012 - 08:45

Të rinjtë me familje kosovare në fokus të studiuesve shkencorë

29/03/2012 - 10:45 | Vjosa Gërvalla



**Ju jeni në mes të
15 dhe 35 vjeç?
Merrni pjesë në
një studim të të
rinjve me prindër
shqiptarë**



Studiuesit akademikë kërkojnë të rinj të moshës 15 deri në 35 vjet për një studim të emigrantëve të rinj të brezit të dytë në Zvicër.

Çfarë mundësie profesionale për fëmijët shqiptarë? Me çfarë vështirësish administrative këta të rinj të shkolluar në Zvicër hasen, kur dihet se në disa raste prindërit gëzojnë vetëm një leje qëndrimi "F"? Si përjetohet përkatësia e dy kulturave për një brez të tërë që nuk ka jetuar të njëjtën histori si të parët e tij?

Këto janë disa nga çështjet që dëshiron të trajtojë poli për kërkime nacionale LIVES (Pôle de recherche national LIVES/ Nationale Forschungsschœerpunkt LIVES) në një studim të ri që do të fillojë këtë pranverë.

Këta shkencëtarë socialë janë të interesuar për çështjen e cenueshmërisë/dobësisë si dhe për mënyrat e ndërmarra për të kapërcyer atë. Me që minoritetet janë rrallë të përfaqësuara në anketat nacionale, anëtarët e polit LIVES, të cilët punojnë në disa shkolla dhe universitete të mëdha, duan të kuptojnë më mirë rrugën e komuniteteve të reja me prejardhje nga ish-Jugosllavia, një popullsi e madhe në Zvicër.

"Nuk është e nevojshme të kemi njohuri apo përgatitje të veçanta për të marrë pjesë në këtë anketë dhe secila dëshmi është e rëndësishme", thotë Andres Gomensoro, i cili është duke përgatitur një doktoraturë në kuadër të këtij projekti. Tashmë ai ka takuar disa persona për të kryer intervista, por në shumicën e rasteve ai ka takuar gra me një nivel universitar. Ndërsa hulumtimi në fjalë synon të takojë njerëz me profile të ndryshme, në mënyrë që të përfaqësojë sa më saktësisht tërësinë e këtyre emigrantëve të brezit të dytë.

Dy mënyra për të dëshmuar

Të dhënat grumbullohen në mënyra të ndryshme. Disa intervista zhvillohen drejtpërdrejt me studiuesin. Kjo është pjesa "cilësore", e cila merr rreth një orë e gjysmë. Për këtë hap, stafi i polit LIVES kërkon kryesisht të rinj të lindur në mes të viteve 1985 dhe 1995 dhe që jetojnë në kantonet e Gjenevës ose të Vaud-it.

Është edhe një pjesë tjetër e studimit e ashtuquajtur "sasiore". Aty, të dhënat do të analizohen në veçanti statistikisht. Ky studim shtrihet në gjithë Zvicrën dhe interesohet për të gjithë ata që kanë lindur mes viteve 1976 dhe 1996. Për studimin sasior, pjesëmarrësit do të kontaktohen deri në fund të prillit nga punonjësit e institutit të sondazhit MIS. Trend për të plotësuar një pyetësor biografik. Është një lloj kalendari ku vihen në dukje të gjitha ngjarjet e rëndësishme të jetës në lidhje me shkollimin, punësimin, vendbanimet, me familjen dhe shëndetin. Mos nguroni të na kontaktoni:

Frengjisht: http://www.lives-nccr.ch/fr/pilote_psm_formulaire ^[5]

Gjermanisht: http://www.lives-nccr.ch/de/pilote_psm_formular ^[6]

[Dërgo shkrimin](#) ^[7] - [Printo](#) ^[8] - [Shtoni komentin tuaj](#) ^[9]

Reagim

0 komentet

[Njoftime](#)

Source URL: <http://www.albinfo.ch/njoftime/t%C3%AB-rinjt%C3%AB-me-familje-kosovare-n%C3%AB-fokus-t%C3%AB-studiuesve-shkencor%C3%AB-65536>

Links:

[1] <http://www.facebook.com/sharer.php?u=http%3A%2F%2Fwww.albinfo.ch%2Fnjoftime%2Ft%25C3%25AB-rinjt%25C3%25AB-me-familje-kosovare-n%25C3%25AB-fokus-t%25C3%25AB-studiuesve-shkencor%25C3%25AB-65536&t=T%C3%AB+rinjt%C3%AB+me+familje+kosovare+n%C3%AB+fokus+t%C3%AB+studiuesve+shkencor%C3%AB>

[2] <http://www.google.com/buzz/post?url=http%3A%2F%2Fwww.albinfo.ch%2Fnjoftime%2Ft%25C3%25AB->

rinjt%25C3%25AB-me-familje-kosovare-n%25C3%25AB-fokus-t%25C3%25AB-studiesve-shkencor%25C3%25AB-65536

- [3] <http://www.linkedin.com/shareArticle?mini=true&url=http%3A%2F%2Fwww.albinfo.ch%2Fnjofitime%2Ft%25C3%25AB-rinjt%25C3%25AB-me-familje-kosovare-n%25C3%25AB-fokus-t%25C3%25AB-studiesve-shkencor%25C3%25AB-65536&title=T%3%AB+rinjt%3%AB+me+familje+kosovare+n%3%AB+fokus+t%3%AB+studiesve+shkencor%3%AB&summary=Studiuesit+akademik%3%AB+k%3%ABrkojn%3%AB+t%3%AB+rinjt%3%AB+mosh%3%ABs+15+deri+n%3%AB+35+vjet+p%3%ABr+nj%3%AB+studim+t%3%AB+emigrant%3%ABve+t%3%AB+rinjt%3%AB+brezit+t%3%AB+dyt%3%AB+n%3%AB+Zvic%3%ABr.%26nbsp%3B%3%87far%3%AB+mund%3%ABsie+profesionale+p%3%ABr+f%3%ABmij%3%ABt+shqiptar%3%AB%3F+Me+%3%A7far%3%AB+v%3%ABshtir%3%ABsish+administrative+k%3%ABta+t%3%AB+rinjt%3%AB+shkolluar+n%3%AB+Zvic%3%ABr+hasen%2C+kur+dihet+se+n%3%AB+disa+raste+prind%3%ABrit+g%3%ABzajn%3%AB+vet%3%ABm+nj%3%AB+leje+q%3%ABndrimi+%E2%80%9CF%E2%80%9D%3F+Si+p%3%ABrjetohet+p%3%ABrkat%3%ABsia+e+dy+kulturave+p%3%ABr+nj%3%AB+brez+t%3%AB+t%3%ABr%3%AB+q%3%AB+nuk+ka+jetuar+t%3%AB+nj%3%ABjt%3%ABn+histori+si+t%3%AB+par%3%ABt+e+tij%3F%26nbsp%3B&source=albinfo.ch>
- [4] <http://twitter.com/home/?status=http%3A%2F%2Fwww.albinfo.ch%2Fnjofitime%2Ft%25C3%25AB-rinjt%25C3%25AB-me-familje-kosovare-n%25C3%25AB-fokus-t%25C3%25AB-studiesve-shkencor%25C3%25AB-65536+--+T%3%AB+rinjt%3%AB+me+familje+kosovare+n%3%AB+fokus+t%3%AB+studiesve+shkencor%3%AB>
- [5] http://www.lives-nccr.ch/fr/pilote_psm_formulaire
- [6] http://www.lives-nccr.ch/de/pilote_psm_formular
- [7] <http://www.albinfo.ch/printmail/65536>
- [8] <http://www.albinfo.ch/print/65536>
- [9] <http://www.albinfo.ch/comment/reply/65536#comment-form>